

STATUTI

I

SHOQËRISË TREGTARE “BANKA e TIRANËS” SH.A. (I PËRDITËSUAR)

Sot më datë 29.06.2020, aksionarët e shoqërisë tregtare “BANKA e TIRANËS” Sh.a, regjistruar si person juridik në Regjistrin Tregtar me NIPT J61924008V, nënshkruan versionin e përditësuar të statutit të shoqërisë datë 20.05.2011 sipas ndryshimeve të miratuara me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 16.03.2012, Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 09.09.2013, Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 18.10.2013 dhe Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 15.05.2019 si më poshtë vijon:

KAPITULLI I

KRIJIMI-FORMA-KOHËZGJATJA-EMËRTIMI-OBJEKTI-KAPITALI THEMELTAR

Neni 1

Shoqëria me emrin e regjistruar “BANKA e TIRANËS” Sh.A dhe emërtimin tregtar “TIRANA BANK” (këtej e tutje quajtur “Banka”) është shoqëri anonime me ofertë private.

Neni 2

Selia e Bankës është Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë.¹

Banka, me vendim të Këshillit Drejtues e me miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë, mund të hapë degë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe filiale apo zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë të Bankës në bazë të këtij Statuti përcaktohet 50 (pesëdhjetë) vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

Banka mund të priset ose të pushojë së vepruari me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve ose me vendim të Bankës së Shqipërisë në zbatim të L.9662/2006.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë të Bankës është kryerja e veprimtarive si më poshtë:

¹ Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 16.03.2012.

(1) Veprimtaritë bankare të:

- a) pranimit të depozitave monetare ose të fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku që do të përoren për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet;
- b) emetimin e mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike.

(2) Veprimtaritë financiare të:

- a) të gjitha formave të kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore e kredinë hipotekore;
- b) faktoringut dhe financimit të transaksioneve tregtare;
- c) qirasë financiare;
- d) të gjitha shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, duke përfshirë kartat e kreditit dhe të debitit, çequet e udhëtarit, çequet bankare dhe kartat e pagesës;
- e) ofrimit të garancive dhe marrjes së angazhimeve;
- f) tregtimit për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i) instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, çertifikata të depozitave etj.);
 - ii) këmbim valutor;
 - iii) produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options);
 - iv) instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje swap dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen;
 - v) letra me vlerë të transferueshme;
 - vi) instrumente të tjera të negociueshme dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin;
 - vii) pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime;
- g) ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:
 - i) administrimin e aktiveve të tilla si, administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit;
 - ii) shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;
 - iii) sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar, si dhe përpunimin e të dhënave financiare e të programeve që kanë lidhje me të, nga furnizuesit e shërbimeve të tjera financiare;
- h) shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara në shkronjat “a” deri “g” të këtij neni, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.

(3) Shërbimin në fushën e sigurimeve të:

- a) ndërmjetësimin në sigurime, si broker pas marrjes së licensave nga organet kompetente.

Veprimtaritë e mësipërme kontribuojnë kryesisht:

- a) në zhvillimin e eksportit shqiptar;
- b) në zhvillimin dhe mbështetjen e kapaciteteve të industrisë, tregtisë dhe turizmit shqiptar për të arritur standartet evropiane;
- c) në zhvillimin e tregut të kapitalit shqiptar;
- d) në futjen e kapitaleve të huaja dhe ndërmjetësimin për investime në Republikën e Shqipërisë;
- e) në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve shqiptare dhe atyre të Bashkimit Evropian dhe të çdo aktiviteti tjetër bankar në përputhje me ligjet në fuqi.

Për arritjen e këtij qëllimi Banka ka të drejtë të bashkëpunojë me persona juridikë ose fizikë ose me cilëndo shoqëri tjetër me të njëjtin objekt, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, me qëllim arritjen e qëllimit të përcaktuar më sipër.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Neni 5²

Kapitali i paguar dhe i regjistruar i Bankës i konvertuar në EURO është EUR 79.911.819,47 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë Euro dhe dyzetë e shtatë Euro Cent) dhe ndahet në 501.975 (pesëqind e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) aksione të zakonshme, secili me vlerë nominale EUR 159,19 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë Euro dhe nëntëmbëdhjetë Euro Cent).

NDRYSHIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR

ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6

Kapitali i regjistruar mund të zmadhohet me emetim të aksioneve të reja kundrejt kontributeve të reja në para, me përfshirje të rezervave të disponueshme dhe fitimeve të pashpërndara (aktive të shoqërisë), ose me shndërrimin e obligacioneve të konvertueshme. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të emetimit të aksioneve shtesë, ose të aksioneve me vlerë nominale më të lartë.

Kapitali themeltar zmadhohet vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

Në rast zmadhimi të kufizuar të kapitalit, vendimi për zmadhimin e kapitalit që realizohet me emetim të aksioneve të reja për t'u nënshkruar vetëm nga aksionerët ekzistues merret vetëm me miratim unanimit të të gjithë aksionerëve (neni 175, L.9901/2008).

Në rast emetimi të obligacioneve të konvertueshme ose obligacioneve me pjesëmarrje në fitim nga Asambleja e Përgjithshme, shoqëria vepron në pajtim me dispozitat e nenit 180 të L.9901/2008.

Mbi aksionet e emetuara rishtazi, aksionerët kanë ose të drejtën e parablerjes, ose të drejtën e pronësisë kjo në përpjestim me pjesën e kapitalit të regjistruar që përfaqësojnë aksionet e zotëruara prej tyre para rritjes së kapitalit. E drejta e parablerjes duhet të

² Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 15.05.2019.

ushtrohet brenda 20 (njëzetë) ditëve nga publikimi i vendimit për rritjen e kapitalit sipas nenit 169 të L.9901/2008.

SHLYERJA DHE VERIFIKIMI I KAPITALIT

Neni 7

Përpara se të kryhet emetimi i aksioneve të nënshkruara me kontribute në para, duhet që kapitali të jetë shlyer plotësisht, përndryshe operacioni konsiderohet i pavlefshëm, në bazë të nenit 170 të L.9901/2008.

Këshilli Drejtues, në çdo rast të zmadhimit të kapitalit, duhet që brenda një afati 3 (tre) mujor nga publikimi i vendimit për rritjen e kapitalit, të verifikojë shlyerjen e kapitalit. Nëse ndonjë aksioner nuk ka shlyer brenda afatit të sipër përmendur shumat përkatëse lidhur me vlerën e aksioneve të nënshkruara prej tij, atëherë shoqëria përfaqësuar nga Këshilli Drejtues mund t'i caktojë atij një afat shtesë 30 (tridhjetë) ditor për ta përmbushur këtë detyrim. Nëse pas këtij afati aksioneri nuk e përmbush detyrimin e shlyerjes së kontributeve, shoqëria përfaqësuar nga Këshilli Drejtues vendos zvogëlimin e kapitalit nëpërmjet anulimit të aksioneve të pambuluara në bazë të rregullave të nenit 186 të L.9901/2008.

ZVOGËLIM I KAPITALIT TË REGJISTRUAR

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit vendoset dhe realizohet vetëm me miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë në bazë të neneve 24 dhe 70 të L.9662/2006.

Zvogëlimi i zakonshëm dhe i thjeshtëzuar i kapitalit realizohet nëpërmjet zvogëlimit të vlerës nominale të aksioneve dhe vendoset nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve në përputhje me kushtet e parashikuara në nenet 181 dhe 185 të L.9901/2008.

Në Asamblenë e Përgjithshme që thirret për zvogëlimin e kapitalit dorëzohet raporti i arsyetuar i Këshillit Drejtues që shpjegon arsyet që bëjnë të detyrueshëm marrjen e vendimit përkatës, si dhe raporti i ekspertëve kontabël të autorizuar, të cilët japin vlerësimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogëlimit.

Zvogëlimi i kapitalit me anulim aksionesh lejohet vetëm kur:

1. ky veprim lidhet me aksionet e veta të blera nga Banka në përputhje me nenin 133 të L.9901/2008; ose
2. aksionerët që i zotërojnë këto aksione pranojnë anulimin.

Anullimi i aksioneve vendoset nga Këshilli Drejtues në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 181 të L.9901/2008.

Në çdo rast, pagesa në favor të aksionerëve e vlerës së aksioneve të anuluar, ose falja e detyrimit të aksionerit për shlyerjen e kontributeve do të kryhet nga Banka në përputhje me dispozitat e pikës 2 të nenit 183 të L.9901/2008.

AKSIONET

Neni 9

Aksionet e Bankës janë nominative, të zakonshme.

Banka, gjatë ekzistencës së saj, mund të emetojë edhe aksione me përparësi që kanë avantazhe në raport me aksionet e zakonshme, duke mbajtur parasysh kërkesat e neneve 116, 122 dhe 149 të L.9901/2008.

Akti i emetimit të aksioneve hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve, si dhe përmban të dhënat e ndjek procedurat e parashikuara nga ligjet në fuqi (N.118, L.9901/2008).

Aksionerët kanë të drejtë të kërkojnë lëshimin e çertifikatës së aksionit nga Banka. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli Drejtues i lëshon çertifikatën e aksionit secilit prej aksionerëve që e kërkon atë. Tipi i çertifikatës së aksionit do të vendoset nga Këshilli Drejtues, i cili do të përcaktojë edhe personat që do të firmosin titujt.

Shoqëria mban regjistrin e aksioneve sipas përcaktimeve të nenit 119 të L.9901/2008.

Neni 10

Një aksion mund të zotërohet nga një apo më shumë persona.

Në rastin kur për një aksion ka më shumë se një zotërues, ata i ushtrojnë të drejtat e aksionerit kundrejt shoqërisë nëpërmjet përfaqësuesit të përbashkët të tyre dhe nëse nuk kanë caktuar përfaqësues, aksioni nuk përfaqësohet dhe ushtrimi i të drejtave që vijnë si pasojë e tij pezullohen.

Personat që zotërojnë një aksion në mënyrë të përbashkët, përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet që rrjedhin nga ky aksion. Ndarja e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga aksioni duhet të përcaktohet në marrëveshjen e lidhur midis personave që e zotërojnë atë, në të kundërt do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil mbi bashkëpronësinë (N.121, pika 3 dhe 5, L.9901/2008).

Veprimet e shoqërisë ndaj aksionit të zotëruar nga shumë persona krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të tij, edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

Neni 11

Aksionerët i ushtrojnë të drejtat e tyre përsa i përket çështjeve të lidhura me veprimtarinë e funksionimin e Bankës nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme.

Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

Neni 12

Çdo aksioner është i lirë të transferojë të gjithë ose një pjesë të aksioneve të tij çdo aksioneri ekzistues ose pale të tretë, pa u kërkuar miratim paraprak nga shoqëria ose ndonjë aksioner.

Çdo transferim i pronësisë të aksionerit me pjesëmarrje influencuese ose ndryshim i pjesëmarrjes influencuese në Bankë, sipas përcaktimeve të nenit 24, pika 1 të L.9662/2006, do të bëhet vetëm me miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

KAPITULLI III ORGANET E BANKËS

Neni 13

Organet e Bankës janë:

- Asambleja e Aksionerëve;
- Këshilli Drejtues;
- Drejtoria;
- Komiteti i Kontrollit.

Kompetencat e organeve të Bankës përcaktohen në këtë statut, si dhe në ligjet e aplikueshme në fuqi.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 14

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Bankës dhe kompetencat e saj përfshijnë marrjen e vendime lidhur me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të Komitetit të Kontrollit;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” e “d” të kësaj pike;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- i) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- j) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- n) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligjet e aplikueshme në fuqi.

Për çështjet që legjislacioni bankar në fuqi kërkon miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, vendimi i asamblesë është i vlefshëm vetëm pas marrjes së këtij miratimi nga shoqëria.

Neni 15

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtoria ose aksionerët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të Bankës (N.139, L.9901/2008). Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë është e nevojshme për interesat e shoqërisë si dhe në rastet e kërkuara nga legjislacioni në fuqi.

Mbledhja e Asamblesë të Përgjithshme mund të mbahet në selinë e shoqërisë ose në çdo qytet tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.³

³ Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 15.05.2019.

Neni 16

Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve bëhet nëpërmjet një njoftimi me shkrim që dërgohet me letër rekomande ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike në adresën e çdo aksioneri. Njoftimi dhe rendi i ditës duhet të merret prej aksionerëve apo të njihet prej tyre, të paktën 21 (njëzetë e një) ditë përpara mbledhjes së asamblesë. Njoftimi përveç ditës, orës, vendit ku mbahet mbledhja, si dhe rendit të ditës duhet të përmbajë gjithashtu edhe të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 2, neni 137 të L.9901/2008.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve që përcakton ky statut dhe legjislacioni në fuqi (N.137, 138 të L.9901/2008), ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë aksionerët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 17

Rendi i ditës i mbledhjeve të asamblesë së aksionerëve përcaktohet nga organi që thërret mbledhjen. Megjithatë një apo disa aksionerë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit, u njihet e drejta për të kërkuar përfshirjen në rend të ditës të çështjeve të caktuara, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 139, pika 1, të L.9901/2008.

Asambleja nuk mund të shqyrtojë një çështje që nuk përcaktohet në rendin e ditës.

Neni 18

Këshilli Drejtues është i detyruar të vërë në dispozicion të aksionerëve, të paktën 21 (njëzetë e një) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, dokumentacionin që përcaktohet nga neni 137, pika 3, e L.9901/2008 nëpërmjet publikimit të tij në faqen e internetit të shoqërisë, ose nëpërmjet marrjes së tij në zyrat qendrore të shoqërisë.

Neni 19

Aksionerët mund të marrin pjesë vetë në Asamblenë e Përgjithshme ose të përfaqësohen në bazë të një autorizimi nga një aksioner tjetër apo nga një person i tretë, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 140 të L.9901/2008.

Aksionerët që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i aksionerëve.

Neni 20

Në rast se një aksioner zotërohet nga më shumë se një person, për çdo shkak dhe arsye, ata janë të detyruar të përcaktojnë përfaqësuesin e tyre, i cili do të ushtrojë të drejtat e aksionerit në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 21

Anëtarët e Këshillit Drejtues, Komitetit të Kontrollit dhe ekspertët kontabël të autorizuar mund të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme me vota konsultative.

Neni 22

Në çdo mbledhje të asamblesë përgatitet lista e aksionerëve të pranishëm dhe e përfaqësuesve të tyre, ku shënohen emrat dhe adresat e secilit, së bashku me numrin e aksioneve, numrin e votave që këto aksione japin, vlerën nominale të aksioneve, si dhe llojin apo kategorinë e tyre, të zotëruara nga secili pjesëmarrës.

Gjithashtu, ecuria e mbledhjeve dhe vendimet që merren në asamble pasqyrohet në procesverbal, i cili mbahet në përputhje me përcaktimet e nenit 143 të L.9901/2008 dhe ruhet në zyrat e shoqërisë.

Neni 23

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe kur mungon ai, drejtohen nga Zëvendës Kryetari.

Kryetari i Asamblesë cakton sekretarin, i cili mund të mos jetë aksioner.

Neni 24

Çdo aksioner ka të drejtë të ketë akses në informacionet e regjistrit të aksionerëve që mbahet nga shoqëria, ose të marrë kopje të listës së aksionerëve 21 (njëzetë e një) ditë më parë se mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 25

Çdo aksioner ka të drejtë, në çdo kohë, që të kërkojë t'i vihen në dispozicion dokumentat e shoqërisë të përmendura në nenin 15 të L.9901/2008, si dhe procesverbalet dhe listën e aksionerëve pjesëmarrës në mbledhjet e asamblesë.

Neni 26

Në rast se shoqëria refuzon pjesërisht apo krejtësisht të drejtën e aksionerit për t'u informuar, e drejtë që i jepet nga nenet e mësipërme, aksioneri që konsideron se preket nga ky veprim ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 27

E drejta e votës që rrjedh nga zotërimi i aksioneve të zakonshme është proporcionale me pjesën e kapitalit që ato përfaqësojnë dhe çdo aksioner jep të drejtën e të paktën një vote.

Aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote sipas kërkesave të nenit 122, pika 2, të L.9902/2008.

Neni 28

TË DREJTAT E PAKICËS

Aksionerët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të regjistruar kanë të drejtë të kërkojnë thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme duke përcaktuar dhe çështjet e rendit të ditës dhe/ose minimalisht 8 (tetë) ditë para mbledhjes së asamblesë mund të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rendin e ditës.

Në rast se Këshilli Drejtues nuk merr parasysh kërkesën e këtyre aksionerëve, secili prej aksionerëve që ka bërë kërkesën ka të drejtë të ndërmarrë veprimet ligjore të parashikuara në nenin 139, pika 2, të L.9901/2008.

Neni 29

ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve ka të drejtë të vendosë lidhur me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, bashkimin, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendosjen e rregullave dhe procedurave për pjesmarrjen e aksionerëve në asamble, si dhe për çështje të tjera që kërkojnë shumicë të kualifikuar në bazë të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionerët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se nuk arrihet kuorumi i kërkuar, Asambleja e Aksionerëve mbledhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e mbledhjes së parë.

Vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve merren me një shumicë votash prej tre të katërtat ($\frac{3}{4}$) që u përkasin aksionerëve që marrin pjesë në votim.

Neni 30

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve vendos për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shoqërinë, përveç atyre për të cilat ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” kërkon që të vendosen me shumicë të cilësuar votash.

Asambleja e Zakonshme merr vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar aksionerët që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të numrit total të aksioneve me të drejtë vote. Në rast të mos arritjes së këtij kuorumi, Asambleja e Aksionerëve mbledhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e mbledhjes së parë.

Vendimet e Asamblesë së Zakonshme të Aksionerëve merren me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët pjesmarrës ose të përfaqësuar.

Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve thirret në mbledhje të paktën 1 (një) herë në vit.

KËSHILLI DREJTUES

Neni 31

Këshilli Drejtues është organ vendimmarrës dhe mbikqyrës i Bankës.

Këshilli Drejtues është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave, si dhe për mbikqyrjen e veprimtarisë së Bankës. Përgjegjësitë e Këshilli Drejtues përfshijnë midis të tjerave:

- a) miratimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave dhe strategjive të Bankës, në lidhje me planin e biznesit, menaxhimin e rrezikut, buxhetin vjetor;
- b) përcaktimin e objektivave afatgjatë të bankës dhe monitorimin e realizimit të këtyre objektivave;
- c) monitorimin e efektivitetit të praktikave të drejtimit të Bankës dhe kryerjen e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e këtyre praktikave;
- d) krijimin e komiteteve, në rast se është e nevojshme, për trajtimin e çështjeve që paraqesin interes të veçantë për Bankën, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kohëzgjatjen e mandatit, përbërjen dhe procedurat e tyre të punës;
- e) përcaktimin e kushteve dhe standardeve për përzgjedhjen, shpërblimin, vlerësimin dhe largimin e drejtorëve të Bankës, si dhe monitorimin e praktikave për zëvendësimin e personelit të Bankës;
- f) monitorimin dhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit të drejtorëve, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të aksionerëve, përfshirë këtu edhe trajtimin e konflikteve të mundshme të interesit, që mund të rrjedhin nga keqpërdorimi i mjeteve të Bankës dhe veprimet me personat e lidhur;
- g) marrjen e masave të nevojshme dhe të mjaftueshme për të siguruar integritetin e sistemeve financiare dhe të kontabilitetit të Bankës, duke përfshirë kontrollin e pavarur të Bankës dhe duke siguruar ekzistencën e sistemeve të përshtatshme të kontrollit, veçanërisht në lidhje me administrimin e rrezikut, sistemin operacional dhe financiar të bankës, si dhe duke siguruar zbatimin e ligjit dhe praktikave më të mira në fushën bankare;
- h) monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullative dhe të praktikave më të mira në sistemin bankar;
- i) mbikëqyrjen e procesit të dhënies së informacionit dhe komunikimin me publikun.

Këshilli Drejtues vendos për çdo çështje që ka të bëjë me drejtimin e Bankës, administrimin e pasurisë së saj dhe në përgjithësi për arritjen e objektivave të saj.

Këshilli Drejtues nuk ka të drejtë të marrë vendim për çështje që janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme. Këshilli jep llogari përpara Asamblesë dhe paraqet raportin vjetor për veprimtarinë e tij.

Neni 32

Këshilli Drejtues përbëhet nga një numer tek anëtarësh, jo më pak se 5 (pesë) dhe jo më shumë se 9 (nëntë).

Anëtarët e Këshillit zgjidhen nga Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve në pajtim me kriteret e përcaktuara në nenin 35 të L. 9662/2006.

Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve.

Secili prej anëtarëve të Këshillit Drejtues mund të delegojë detyrat e tij te persona të tjerë të tretë, por mban përgjegjësi për vendimet e tyre. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk kanë përgjegjësi personale kundrejt të tretëve dhe kundrejt aksionerëve të Bankës, por kanë përgjegjësi kundrejt personit juridik të shoqërisë për detyrat që u janë ngarkuar.

Neni 33

Këshilli Drejtues zgjedh nga gjiri i tij Kryetarin dhe Zëvendës Kryetarin, që kanë për detyrë të mbledhin Këshillin dhe të drejtojnë seancat e mbledhjeve të tij. Kryetari kryeson mbledhjen dhe në mungesë të tij, zëvendësohet nga Zëvendës Kryetari.

Mbledhja e Këshillit Drejtues mbahet në mënyrë të rregullt ose në selinë e shoqërisë, ose në cilindo qytet tjetër brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, të paktë një here në 3 (tre) muaj, ose në raste të jashtëzakonshme pas kërkesës të të paktën 2 (dy) anëtarëve të Këshillit.⁴

Neni 34

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues caktohet për një periudhë 4 (katër) vjeçare. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen për periudha vijuese.

Në rastin e vendeve bosh që krijohen nga vdekja ose dorëheqja e një ose disa anëtarëve të Këshillit Drejtues, ose nga mungesa e pajustificuar e një anëtari të Këshillit Drejtues nga mbledhjet për tre muaj rresht, Këshilli, deri në mbledhjen e Asamblesë së Aksionerëve, mund të zgjedhë anëtarë të përkohshëm nga administratorët e miratuar nga Banka e Shqipërisë. Në këtë rast, Këshilli Drejtues ose Drejtoria thërret menjëherë Asamblenë e Aksionerëve.

Neni 35

Vendimet e Këshillit Drejtues quhen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjes janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e Kryetarit është përcaktuese.

Anëtarët e Këshillit mund ta shprehin votën e tyre me shkresë, me telefon apo me mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i Këshillit ka kundërshtime të arsyeshme për këtë mënyrë vendimmarrjeje.

Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës në rastet e parshikuara nga neni 148 i L.9901/2008.

Neni 36

Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Drejtues regjistrohet në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari dhe në mungesë të tij nga Zëvendës Kryetari. Procesverbali përmban vendin dhe datën e takimit, emrat e pjesëmarrësve, rendin e ditës, një përshkrim për çështjet e diskutuara e vendimet e marra. Gjithashtu, në procesverbal shënohen edhe mendimet e atyre që nuk janë dakort.

Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të delegojnë detyrat e tyre te persona të tretë të tjerë, por mbajnë përgjegjësi për vendimet e tij.

⁴ Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 15.05.2019.

Për anëtarët e Këshillit Drejtues jepet shpërblim, i cili përcaktohet me vendim të Asamblesë së Aksionerëve në përputhje me parashikimet e nenit 160 të L.9901/2008.

Neni 37

Aksionerët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) % të kapitalit të regjistruar kanë të drejtë t'i kërkojnë Këshillit Drejtues të kryejë mbikëqyrje të veçantë për çështje të posaçme, dhe veçanërisht lidhur me ligjshmërinë e veprimeve të Drejtorisë.

DREJTORIA

Neni 38

Drejtoria kryen drejtimin dhe organizimin e ushtrimit të veprimtarisë së Bankës.

Drejtoria e shoqërisë përbëhet nga një ose më shumë drejtues ekzekutiv që emërohen nga Këshilli Drejtues. Anëtarët e Drejtorisë mund të jenë anëtar të thjeshtë të Këshillit Drejtues.

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të Drejtorisë caktohet për një periudhë 3 (tre) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen në çdo kohë nga Këshilli Drejtues.

Mënyra dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të Drejtorisë caktohet në aktin e emërimit.

Neni 39

Drejtoria duhet të informojë menjëherë Kryetarin e Këshillit Drejtues në rastet e parashikuara në pikat 3 - 5 të nenit 136 të L.9901/2008.

Nëse Drejtoria përbëhet nga më shumë se një drejtues ekzekutiv, ata do ta administrojnë Bankën në mënyrë të përbashkët, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe ose në vendimin e Këshillit Drejtues për emërimin e tyre, ose në rregulloret (aktet e brendshme) e miratuara nga ky Këshill.

Neni 40

Drejtoria ka kompetenca të plota për të përfaqësuar Bankën.

Banka në marrëdhënie me të tretët merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga veprimet e Drejtorisë, edhe kur këto veprime tejkalojnë objektin e Bankës, përveç kur këto veprime shkojnë përtej të drejtave të përfaqësimit që jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve, si dhe nëse i treti ka pasur dijeni se Drejtoria ishte në tejkalim të kompetencave të saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të (neni 12, L.9901/2008).

Nëse Drejtoria përbëhet nga më shumë se një drejtues ekzekutiv, ata kanë të drejtë ta përfaqësojnë Bankën së bashku dhe/ose në mënyrë individuale në marrëdhënie me të tretët.

KOMITETI I KONTROLLIT

Neni 41

Komiteti i Kontrollit përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët emërohen nga Asambleja e Aksionerëve për një periudhë 4 (katër) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Anëtarët e Komitetit të Kontrollit nuk mund të jenë punonjës ose drejtues ekzekutivë të Bankës, por mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues.

Neni 42

Kompetencat e Komitetit të Kontrollit janë këto:

- a) kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e procedurave kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të Bankës, duke përfshirë edhe procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
- b) shqyrton raportet e kontrollit të brendshëm dhe monitoron trajtimin e përfundimeve të dala nga këto raporte;
- c) propozon ekspertin kontabël të autorizuar dhe realizon komunikimin ndërmjet tij dhe kontrollit të brendshëm të Bankës;
- d) bën vlerësimin e situatës financiare të Bankës, bazuar në raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
- e) kontrollon përputhshmërinë e veprimtarisë së Bankës me aktet ligjore dhe nënligjore dhe njofton për përfundimet Këshillin Drejtues të Bankës;
- f) i jep mendim Këshillit Drejtues të Bankës për të gjitha problemet që i kërkohen prej këtij të fundit;
- g) miraton raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga Banka, me qëllim publikimin e tyre.

Komiteti i Kontrollit mblidhet jo më pak se 3 (tre) herë në vit në mbledhje të zakonshme, dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga Këshilli Drejtues i Bankës. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Abstenime nuk lejohen.

Komiteti i Kontrollit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.

Komiteti i Kontrollit raporton përpara Këshillit Drejtues dhe e ndihmon Këshillin në vendimmarrjen dhe mbikqyrjen e Bankës.

Dhënia e shpërblimit për anëtarët e Komitetit të Kontrollit vendoset nga Asambleja e Aksionerëve të Bankës.

Neni 43

Marrëveshjet e anëtarëve të Këshillit Drejtues, të Drejtorisë dhe të anëtarëve të Komitetit të Kontrollit me Bankën mund të jenë objekt i miratimit paraprak në përputhje me përcaktimet e nenit 13 të L.9901/2008.

KAPITULLI VI

Neni 44

AUDITIMI I BANKËS

EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

Asambleja e Aksionerëve emëron si ekspert kontabël të autorizuar të Bankës një person juridik të licencuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë dhe të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e raporteve financiare të bankës me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Eksperti kontabël i autorizuar kontrollon dhe vlerëson:

- a) llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve);
- b) bilancin kontabël;
- c) raportin për ndryshimet në kapital;
- d) pasqyrën e cash – flow;
- e) zbatimin e politikave të fshirjes së zërave të bilancit;
- f) raportet e konsoliduara;
- g) funksionin e kontrollit të brendshëm;
- h) regjistrimet kontabël;
- i) sistemet e informacionit;
- j) saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura në Bankën e Shqipërisë;
- k) mjaftueshmërinë e procedurave kontabël dhe zbatimin e rregulloreve;
- l) shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

Eksperti kontabël i autorizuar:

- a) verifikon mbajtjen ose jo në mënyrën e duhur të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë;
- b) përgatit raport vjetor së bashku me opinionet e kontrollit të brendshëm, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të Bankës, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga Banka, në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit;
- c) shqyrton mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe të praktikave e procedurave kontrolluese, si dhe bën rekomandimet përkatëse.

Ekspertët kontabël të autorizuar sigurohen që është respektuar barazia ndërmjet aksionerëve.

Neni 45

Eksperti kontabël i autorizuar u paraqet kopje të raportit të auditimit Asamblesë së Aksionerëve dhe Komitetit të Kontrollit të Bankës.

Eksperti kontabël i autorizuar njofton ose informon Bankën e Shqipërisë për ato fakte ose vendime të Bankës që përcaktohen në pikat 2, 3 e 4 të nenit 50 të L.9662/2006.

Neni 46

Eksperti kontabël i autorizuar emërohet për një kohëzgjatje prej 1 (një) vit financiar. Funksionet e tij përfundojnë pas Asamblesë së Përgjithshme, e cila merr vendim mbi llogaritë vjetore.

Neni 47

Ekspertët kontabël të autorizuar mund të shkarkohen nga funksionet e tyre nga Asambleja e Aksionerëve.

Neni 48

Banka duhet të mbajë në zyrat e saj librat kontabël, si dhe harton e publikon raportin vjetor sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 53 të L.9662/2006.

Librat zyrtarë të Bankës dhe tabelat financiare vjetore, bilancet financiare dhe raportet financiare vjetore mbahen në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Neni 49

Viti financiar ka kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar nga data 1 Janar deri në datën 31 Dhjetor të çdo viti.

Në fund të çdo viti financiar, Këshilli Drejtues miraton bilancin dhe llogaritë vjetore në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe përpilon raportin vjetor të administrimit.

Neni 50

REZERVA LIGJORE

Banka nga fitimi pas tatimit i realizuar gjatë vitit paraardhës financiar, pasi të jenë zbritur po të jetë e nevojshme humbjet e vitit të mëparshëm, kalon në rezervën ligjore një shumë me vlerë të paktën 5% (pesë përqind) e tij, e cila destinohet për formimin e një fondi rezervë, të quajtur “rezervë ligjore”. Kjo procedurë pushon së qeni e detyrueshme kur shuma e rezervës ligjore arrin masën e 10% (dhjetë përqind) të kapitalit të paguar.

Neni 51

NDARJA E FITIMEVE

Fitimet që do të ndahen, janë fitimet e vitit financiar mbasi të jetë zbritur rezerva ligjore, në bazë të nenit të mësipërm.

Neni 52

PËRCAKTIMI I DIVIDENTËVE

Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së shumave që do të shpërndahen, Asambleja e Përgjithshme përcakton pjesën që u takon aksionerëve në formë dividendësh, në bazë të nenit 128 të L.9901/2008.

KAPITULLI V

Neni 53

KUJDESTARIA

Banka e Shqipërisë mund të vendosë Bankën në kujdestari, në rastet e parashikuara në nenin 96 të L.9662/2006, dhe sipas procedurave dhe kompetencave të përcaktuara në nenet 96 – 105 të L.9662/2006.

Neni 54

LIKUIDIMI VULLNETAR

Likuidimi vullnetar është prishja e Bankës që vendoset nga Mbledhja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve me vullnetin e aksionerëve të Bankës dhe sipas kushteve të parashikuara në nenin 107 të L.9662/2006.

Banka priset në këto raste:

- 1) aksionerët vendosin vullnetarisht të kalojnë Bankën në proces likuidimi dhe për këtë vendim duhet të njoftojnë paraprakisht Bankën e Shqipërisë;
- 2) aksionerët vendosin për ndryshimin e veprimtarive të Bankës dhe për të mos vazhduar më ushtrimin e veprimtarisë bankare.

Emërtimi i bankës pasohet nga shënimi “bankë në likuidim”.

Likuidimi vullnetar i Bankës bëhet në bazë të dispozitave të L.9662/2006 dhe të L.9901/2008 përsa nuk bien në kundërshtim me të parin.

Neni 55

LIKUIDIMI I DETYRUAR

Banka e Shqipërisë vendos Bankën në likuidim të detyruar në rastet e përcaktuara në nenin 108 të L.9662/2006.

Të gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga Banka përmbajnë emërtimin e saj shoqëruar nga shënimi “bankë në likuidim të detyruar”.

Likuidimi i detyruar i Bankës bëhet në përputhje me nenet 108-123 të L.9662/2006.

KAPITULLI VI

Neni 56

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Për çështje që nuk parashikohen nga ky statut zbatohen dispozitat në fuqi të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”, si dhe ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 57⁵

MBULIMI I KAPITALIT AKSIONER

Kapitali aksioner mbulohet si më poshtë:

Aksionarët	Nr. i aksioneve	Pjesëmarrja (EUR)	Pjesëmarrja (%)
BALFIN Sh.p.k	452.365	72.014.164,48	90,12
KOMERCIJALNA BANKA AD SKOPJE	49.610	7.897.654,99	9,88
TOTALI	501.975	79.911.819,47	100,00

Neni 58⁶

Logo e Bankës do të miratohet nga Mbledhja e Asamblesë së Aksionerëve dhe do të vendoset edhe në vulën e saj sipas nenit 34 të L.9662/2006.

Neni 59

Ky statut redaktohet në 5 (pesë) kopje origjinale nga të cilat një kopje depozitohet në zyrën e noterisë, një kopje në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje pranë Organeve Tatimore të Rrethit Tiranë, një kopje në Bankën e Shqipërisë dhe një kopje mbahet në zyrat e shoqërisë.

Neni 60

Statuti datë 20.10.1995 (vërtetuar me nr.13536rep. e nr.4675kol., date 20.10.1995 nga notere Shpresa Spahiu) është shfuqizuar nga statuti datë 20.05.2011 i ndryshuar siç



⁵ Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 15.05.2019.

⁶ Ndryshuar me Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve datë 15.05.2019.



deklarohet këtu mësipër dhe që përbën dokumentin bazë që rregullon funksionimin e shoqërisë “BANKA e TIRANËS” Sh.A.

AKSIONARËT

Balfin Sh.p.k
përfaqësuar nga:


(emër, mbiemër, pozicioni)


Komercijalna Banka AD Skopje
përfaqësuar nga:


(emër, mbiemër, pozicioni)


Përktheu: